

VENDIM
Nr. 23, datë 24.6.2015

PËR LICENCIMIN E “UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR” SHA

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit dhe shtesë kategorie për operatorin “Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër” sh.a. me:

- a) Drejtues ligjor: Leonard Kepi;
- b) Drejtues teknik: Shpresa Kodra;
- c) Drejtues teknik: Marsida Nikshiqi.

2. Operatori “Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër” sh.a. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

- a) Kategoria A “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
- b) Kategoria C “Për largimin e ujërave të ndotura”;
- c) Kategoria D “Për përpunimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Shkodër, komuna Rrethinat (pjes.).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 23.6.2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi